



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

DATE/A:	19.05.2026
PËR/ZA/TO:	Kryetarin e Komunës Kryesuesin e Kuvendit Drejtorët e Drejtorive Komunale
NGA/OD/FROM:	Ardita Hoxha Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	NJOFTIM



Të nderuar !

Bazuar në ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr 03/L-048, neni 60, Ligjin për Vetëqeverisje lokale (Ligji Nr:03/ L-040) dhe Statutin e Komunës, pas pranimit të Qarkores Buxhetore 2027/01 në formë elektronike nga Ministria e Financave me datë 15.05.2026, Komuna ka për obligim fillimin e Procedurave të planifikimit të Buxhetit për periudhën 2027-2029 në përputhje me limitet buxhetore të përcaktuara në KASH-in (Korniza Afatmesme e Shpenzimeve) për Komunat.

Përmes këtij njoftimi keni obligim që të hartoni planifikimet për Programin tuaj përkatës dhe ti dorëzoni në email apo edhe fizike tek drejtoria për Buxhet dhe Financa deri me datë 28.05.2026.

Në formë elektronike do ti keni të bashkangjitura Qarkoren Buxhetore komunale 2027/01 nga Ministria e Financave, Qarkoren e brendshme komunale #2027-01 dhe formularët e nevojshëm për paraqitjen e propozimeve nga ana juaj.

Bashkangjitur në email:

- A) Deklarata për misionin dhe performansën sipas Drejtorive/ Programeve
- B) Qarkorja Buxhetore nr. 2027/01 për Komuna (MFPT)
- C) Qarkorja e brendshme buxhetore komunale #2027/01
- D) Formularët A dhe B, veçantë për Drejtoritë dhe programet buxhetore,
- E) Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028 (e vitit te kaluar) ku mund të mbështeteni për ndryshimet që planifikoni të bëni për vitet 2027-2029.

Me respekt!